



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË**

Nr. _____ prot

Vlorë, _____ .2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____ .2023

**“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË TERRITORIN E BASHKISË
VLORË, PER VITIN 2024”**

Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës _____ .2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë Vlorë, mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, neni 9 pika 1.1 gërmat a, b, pika 1.3, Neni 35 dhe Neni 54 pika f;
- Ligjin 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”;
- Ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar,
- Ligjin nr.98/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”
- Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"
- VKM nr. 408, datë 31.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"
- Ligjin 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit” neni 17,18,19;
- Ligjin 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar
- VKM nr.132, datë 07.03.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar.

VENDOSI:

I. TË MIRATOJË TAKSAT VENDORE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË SI VIJON:

TAKSAT VENDORE

1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN

- a. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 14 milionë lekë është 0 (zero).

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekti tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

2.TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Kjo taksë rregullohet nga VKM nr.132, datë 07.03.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

a. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesa”:

1. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme llogaritet si më poshtë:

[Çmimi Vlerësues] x [Shkalla e taksës] x [Koeficient e qëllimit të përdorimit të pronës]

a. Çmimi vlerësues përcaktohet duke ndjekur radhën e mëposhtme të caktuar

- I. Në bazë të vetëdeklarimit
- II. Çmimi i vlerësuar sipas Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
- III. Çmimi referues mesatar sipas aneksit 1 dhe 2

b. Shkalla e taksës

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si mëposhtë:

- I) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- II) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- III) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Bashkia	Njësia	Koeficient i taksës sipas njësive
Vlorë	Vlorë	100%
Vlorë	Novoselë	65%
Vlorë	Shushicë	65%
Vlorë	Qendër	65%
Vlorë	Orikum(Qytet)	100%
Vlorë	Orikum (Rurale)	67%

b. Koeficient të qëllimit të përdorimit të pronës

Qëllimi i Përdorimit të Pronës	Koeficienti
Për banesa pas vitit 1993	100%
Për banesa para vitit 1993	70%
Njësi Tregtimi dhe Shërbimi	150%
Për Parkim të Mbuluar dhe Bodrumet	70%
Për Parkim të Hapur	30%

Për Veprimtari Industriale	50%
Për Veprimtari Bujqësi dhe Blegtori	30%

Dokumentacioni që përdoret për përcaktimin e bazës së taksës është vërtetimi hipotekor, dokumenti i vlerësimit nga ALUIZNI (ASHK), kontratë qeraje.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndoshet ndërtesa. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

2. Për banesat në njësitë administrative, do të reduktohet çmimi mesatar si më poshtë:
 - a. Njësitë Novoselë, Shushicë, Qendër do të reduktohet çmimi mesatar referues në -35% të qytetit Vlorë.
 - b. Njësia Orikum (Zona rurale) do të reduktohet çmimi mesatar referues në -33% të Qytetit Orikum.

3. Për njësitë Administrative Novoselë, Orikum, Shushicë, dhe Qendër, do të përfitojnë 30% ulje nga taksa e pasurisë për çdo kategori përkatëse. Për ndërtesat e banimit të ndërtuara përpara vitit 1993 në qytetin e Vlorës një reduktim i kësaj takse prej 30%.

4. Për ndërtesat të cilat përdoren si objekte nga institucionet arsimore jo publike do të reduktohet shkalla e taksës me 30%.

5. Për ato kategori ndërtesash banimi, të cilat janë të rregjistruara si seli të subjekteve tregëtare, taksa e pasurisë përlllogaritet dhe paguhet si ndërtesa për biznes, sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë, duke u përjashtuar nga kategoria ndërtesa banimi. Për të gjitha rastet e mësipërme, brenda datës 31 dhjetor të vitit fiskal, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, do të bëhen rakordimet e pagesave me agjentin e mbledhjes së taksës, për diferencën e taksës së paguar si taksë "ndërtese banim".

6. Kur vlerësimi sipas pikave 1.a.I dhe 1.a.II më lart është i pamundur, çmimi i vlerësuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore do të llogaritet tabelës së mëposhtme:

Shkalla e taksës për banesat			0.050%	Pas viti 1993	
Bashkia	Njësia	Çmimi referues për m ²	Koeficient i taksës sipas njësisë	Shkalla e taksës (ligji 68/2017 lejon deri +/- 30%)	Vlera vjetore për taksën në m ²
Vlorë	Vlorë	61,800	100%	100%	30.90
Vlorë	Novoselë	61,800	65%	70%	14.06
Vlorë	Shushicë	61,800	65%	70%	14.06
Vlorë	Qendër	61,800	65%	70%	14.06
Vlorë	Orikum(Qytet)	60,000	100%	70%	21.00
Vlorë	Orikum (Rurale)	60,000	67%	70%	14.07
Shkalla e taksës për banesat			0.050%	Para viti 1993	
Bashkia	Njësia	Çmimi referues për m ²	Koeficient i taksës sipas njësisë	Shkalla e taksës (ligji 68/2017 lejon deri +/- 30%)	Vlera vjetore për taksën në m ²
Vlorë	Vlorë	43,260	100%	70%	15.14
Vlorë	Novoselë	43,260	65%	70%	9.84
Vlorë	Shushicë	43,260	65%	70%	9.84

Vlorë	Qendër	43,260	65%	70%	9.84
Vlorë	Orikum(Qytet)	42,000	100%	70%	14.70
Vlorë	Orikum (Rurale)	42,000	67%	70%	9.85

Shkalla e taksës për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim							
Bashkia		Vlorë	Vlorë	Vlorë	Vlorë	Vlorë	Vlorë
Njësia		Vlorë	Novoselë	Shushicë	Qendër	Orikum (Qytet)	Orikum (Rurale)
Çmimi referues për m²		61,800	61,800	61,800	61,800	60,000	60,000
Shkalla e taksës sipas VKM 132/2018		100%	65%	65%	65%	100%	67%
Shkalla e taksës sipas ligjit 68/2017		100%	70%	70%	70%	70%	70%
Qëllimi i përdorimit të pronës	Koeficient	Vlera vjetore për taksën në m²					
Njësi Tregtimi dhe Shërbimi	150%	185.40	84.36	84.36	84.36	126.00	84.42
Për Parkim të Mbuluar dhe Bodrumet	70%	86.52	39.37	39.37	39.37	58.80	39.40
Për Parkim të Hapur	30%	37.08	16.87	16.87	16.87	25.20	16.88
Për Veprimtari Industriale	50%	61.80	28.12	28.12	28.12	42.00	28.14
Për Veprimtari Bujqësi dhe Blegtori	30%	37.08	16.87	16.87	16.87	25.20	16.88

****Njësi Tregtimi dhe Shërbimi (Institucione arsimore jo publike në qytetin e Vlorës) – 129.8 lekë/m²**

7. Për ndërtesat e banimit që i mungon dokumentacioni për përcaktimin e sipërfaqes dhe vitit të ndërtimit, niveli i taksës do të jetë:

- 3,100 lekë/vit për banesat në Qytetin e Vlorës
- 2,200 lekë/vit për banesat në Qytetin e Orikut
- 1,500 lekë/vit për banesat në zonat e tjera

Këto tarifa do të aplikohen deri në momentin e përfundimit të vetëdeklarimit nga qytetarët, i cili do të bëhet pranë Zyrrave të Njësive Administrative, Zyrrave të Rajoneve 1,2,3,4,5, Drejtorisë së të Ardhurave Vendore për familjet që kanë dhe biznes.

8. Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat sipas ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 22 pika 6:

- pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- banesat sociale në pronësi të bashkive;
- pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.”

9. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës dhe mënyra e pagesës, kategoria familje:

Detyrimi për familjet likujdohet në bazë mujore, referuar marrveshjes me agjentin tatimor. Për shërbimin, agjenti përfiton deri në 3% të shumës së arkëtuar, në bazë të Akt-marrëveshjes së lidhur midis Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe agjentit tatimor.

Për ndërtesat e banimit, mbas krijimit të regjistrave për këtë taksë, llogaritja e detyrimit do të kryhet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, e cila do ti përcillet me shkresë përcjellëse agjentit tatimor. Deri në momentin e krijimit të një regjistri nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore me të dhënat për objektet që shfrytëzohen për banim, faturimi dhe arkëtimi i kësaj takse, do vijojë të bëhet nga agjenti tatimor, në bazë të marrëveshjes midis palëve.

10. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës dhe mënyra e pagesës:

Detyrimi për kategorinë biznes llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

Afati për llogaritjen dhe pagesën e taksës do të jete deri në datën 20 prill të vitit fiskal. Në rast mospagimi në afat të detyrimit tatimor, subjekti detyrohet të paguajë gjobë me 0.06% të shumës së papaguar për çdo ditë vonesë. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Përgjashtimisht, të gjithë subjektet ku detyrimi i taksës së ndërtesës kalon vlerën 50,000 lekë, me kërkesë të subjektit mund të lidhin marrveshje me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, për kryerjen e pagesës në dy këste të barabarta, përkatësisht me afat pagese, deri në 20 prill dhe 20 tetor.

b. Taksa mbi tokën bujqësore.

Tokë bujqësore është toka e përcaktuar si e tillë në rregjistrin e Agjencisë së Kadastrës Shtetërore.

Baza e taksës, është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, certifikatë të rregjistrimit të tokës.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetdeklarim të sipërfaqes të tokës, pranë njesise administrative ku ndodhet toka.

Nr.	Klasifikimi i kategorisë së tokës bujqësore	lekë/ha në vit
1	I	5,600

2	II	4,900
3	III	4,200
4	IV	3,600
5	V	3,000
6	VI	2,400
7	VII – X	1,800

Shënim: Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore është marrë nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ku për Bashkinë Vlorë do të përdoren këto taksa:

Ekonomia		Kategoria	Lekë/ha në vit	Nën kategorizim (11.2 – 14.3%)
Bashkia Vlorë	Ish N.B.Ullishte	VII	1,800	
	Ish N.B.Rinia	III	4,200	3,600
Nj.A. Novoselë	Fitore	IV	3,600	3,200
	Akërn	VIII	1,800	
	Novoselë	V	3,000	
	Aliban	V	3,000	
	Mifol	V	3,000	
	Bishan	IV	3,600	3,200
	Poro	V	3,000	
	Delisuf	VI	2,400	
	Dëllënjë	VI	2,400	
	Trevllazër	VI	2,400	
	Cerkovinë	VI	2,400	
	Skrofotinë	VI	2,400	
Nj.A. Orikum	Dukat	VI	2,400	
	Tragjas	VI	2,400	
	Orikum	III	4,200	3,600
	Radhimë	III	4,200	3,600
	Jonufër 2	III	4,200	3,600
Nj.A. Qendër	Babicë e Madhe	VI	2,400	
	Babicë e Vogël	VI	2,400	
	Xhuherinë	VI	2,400	
	Kaninë	V	3,000	
	Kërkovë	VI	2,400	
	Zvërnec	VI	2,400	
	Sherishtë	V	3,000	
	Panaja	VI	2,400	
	Hoshtimë	VI	2,400	
	Nartë	VI	2,400	
	Bestrovë	VII	1,800	
Nj.A. Shushicë	Risili	IV	3,600	3,200
	Bunavi	IV	3,600	3,200
	Ceprat	IV	3,600	3,200
	Llakatund	IV	3,600	3,200
	Shushicë	IV	3,600	3,200
	Grabian	IV	3,600	3,200
	Drithas	IV	3,600	3,200

	Mekat	IV	3,600	3,200
	Beshisht	IV	3,600	3,200

Lehtësime ose përjashtime nga pagesa e taksës së mësipërme:

- Personat të cilat kanë të ardhura nën minimumin jetik të nivelit kombëtar.
- Tatimpagues, pasuria e të cilëve është dëmtuar nga forca madhore. Masa e lehtësisë tatimore të jetë e njëjtë me masën e dëmit të shkaktuar, por jo më shumë se **75 %**.
- Tokat që mbillen për herë të parë, me kultura drufrutorë dhe vreshtari, në 3 vitet e para do të paguajnë 70 % të nivelit të taksës, sipas tabelës së mësipërme.

Struktura përgjegjëse për mbledhjen e kësaj takse b/1-7:

- Struktura përgjegjëse për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.
- Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve është struktura përgjegjëse për përgatitjen dhe përcjelljen pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, të regjistrimit të tokës bujqësore për çdo njësi administrative me të dhënat për vlerësimin tatimor.
- Afati për pagesën e taksës është 20 korrik dhe 20 dhjetor i vitit fiskal. Në rast të mospagimit në afat të detyrimit tatimor, subjekti detyrohet të paguajë gjobë me 0.06% të shumës së papaguar për çdo ditë vonesë. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike
- Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, ngarkohet që në të gjitha rastet kur ka ndryshime të kategorisë së tokës, të pasqyrojë përditësimet në regjistrin e tokës bujqësore, dhe ta përcjelli pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.

c. Taksa mbi truallin

Trualli është pasuri e paluajtshme emërtuar, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Vlera e taksës në lekë m²/vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë m²/vit për qëllime biznesi
1	Takse trualli	0.56 lekë/m ²	20 lekë/m ²

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit, që nuk përfshin truallin nën objekt (pjesa e truallit mbi të cilin është ndërtuar ndërtesa, taksohet vetëm si taksë ndërtesë, ndërsa si truall taksohet pjesa që mbetet). Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Struktura përgjegjëse për mbledhjen e kësaj takse dhe mënyra e pagesës:

Mbledhja e taksës do të kryhet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

Mënyra e pagesës: Taksa mbi truallin do të paguhet brenda datës 20 prill të vitit kalendarik. Mospagimi në afat i detyrimit tatimor, subjekti detyrohet të paguajë gjobë me 0.06% të shumës së papaguar për çdo ditë vonesë. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Përgjashtimisht, të gjitha subjektet për të cilat vlera e taksës së truallit kalon vlerën 100,000 lekë, me kerkese të subjektit, nëpërmjet marrveshjes me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, pagesa mund të behet në katër këste, përkatësisht deri në 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor.

3.TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Baza e taksës është numri netëve të qëndruara në hotel për person

Niveli tregues i taksës së hotelit është:

Nr	Emërtimi	Niveli i taksës
1	Hotele me 4-5 yje	175 lekë/ natë qëndrimi për person
2	Hotele deri në 3 yje, bujtinë, fjetinë, motel, çdo njësi tjetër akomoduese	70 lekë/natë qëndrimi për person

Struktura përgjegjëse për mbledhjen e kësaj takse, afati i pagesës dhe mënyra e pagesës:

Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

- Çdo datë 5 të muajit pasardhës, subjekti tatimpagues duhet të dorëzojë në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, regjistrin e fjetjes në hotel.
- Për kategorinë e bizneseve të cilët nuk do të deklarojnë nëpërmjet sistemit të fiskalizimit dhe rregjistrin të fjetjes në hotel, faturimi i kësaj takse do të bëhet mbi bazën e veprimeve që subjekti kryen në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për kohën e ushtrimit të aktivitetit, si për subjektet me aktivitet sezonal dhe subjektet me aktivitet gjatë gjithë vitit.

Vlerësimi tatimor për njësitë akomoduese do të jetë sipas procedurës:

- subjektet të cilët nuk janë kontaktuar për arsye të adresës së gabuar ose të rregjistruar rishtazi, do të zbatohet tarifa dhe netët e fjetjes sipas klasifikimeve në tabelën e mëposhtme.
- subjektet që ushtrojnë aktivitet për një periudhë të përkohshme, taksa e fjetjes në hotel llogaritet vetëm brenda kësaj periudhe. Llogaritja e taksës bëhet mbi bazën e regjistrin të fjetjes në hotel, të të ardhurave të deklaruara në sistemin e fiskalizimit, vlerësimit alternativ të kryer nga inspektori dhe sipas tabelës së klasifikimit të zonës (sipas hartave bashkëlidhur), në bazë të ditëve të ushtrimit të aktivitetit.

Nr	Emërtimi i zonës	Aktivitet në QKB	Ditë/dhomë
1	Subjekte me veprimtari njësi akomoduese përgjatë Zonës A (Zona Uji Ftohtë – Radhimë - Oriku)	7 – 12 muaj	150
		4 - 6 muaj	120
		3 muaj	90
2		7 – 12 muaj	120

	Subjekte me veprimtari njësi akomoduese përgjatë Zonës B (Zona Plazh i Vjetër - Zvërnec)	4 - 6 muaj	100
		3 muaj	75
3	Subjekte me veprimtari njësi akomoduese përgjatë Zonës C (cdo zonë e cila nuk përfshihet në Zonën A dhe B)	7 – 12 muaj	130
		4 - 6 muaj	100
		3 muaj	75

Për subjektet të cilët ushtrojnë aktivitet tregëtar më pak se 3 muaj, vlerësimi tatimor do të kryhet në përputhje me ditët e ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të QKB-së.

Për njësitë akomoduese që nuk kanë depozituar informacionin e kërkuar ose nuk kanë deklaruar të dhëna të sakta, do të rivlerësohen sipas parashikimeve ligjore të sanksionuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.Sh” neni 71, 72 i ligjit.

Afati i pagesës së detyrimit, do të jetë data 20 gusht.

Në rast të mospagimit në afat të detyrimit tatimor, subjekti detyrohet të paguajë gjobë me 0.06% të shumës së papaguar për çdo ditë vonesë. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike

4.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e Ndërtimit	
1.1	Për zonën nga Petrolifera deri tek Tuneli (vija e parë) sipas hartës bashkëlidhur.	8% e çmimit të shitjes
1.2	Për zonat e tjera në qytetin e Vlorës, fshati Kaninë, fshati Zvërnec, njësia Oriku (përveç pikës 1.1 dhe 1.6).	6% e çmimit të shitjes
1.3	Njësia Qendër (me përjashtim të fshatit Kaninë, Zvërnec)	4% e çmimit të shitjes
1.4	Njësia Shushicë	4% e çmimit të shitjes
1.5	Njësia Novoselë	4% e çmimit të shitjes
1.6	Njësia Oriku: fshatrat Dukat, Dukat i Ri, Tragjas, Radhimë, sipas hartës bashkëlidhur.	6% e çmimit të shitjes
1.7	Rigjenerim i zonave në pallatet e vjetra të ndërtuara para vitit 1993 (ku përfshihet prishja e pallateve të vjetra, dhe ndërtimi sipas PPV në fuqi)	6% e çmimit të shitjes
2	Për ndërtime për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë, përdorim publik.	3% e vlerës së investimit (jo më pak se vleraminimale fiskale e ndërtimit)
2.1	Për ndërtime për përdorim në sektorin e bujqësisë të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës.	1% e vlerës së investimit (jo më pak se vlera minimale fiskale e ndërtimit)
3	Njësi banimi një familjare kur investitori është vetë familjari, Qyteti Vlorë, qyteti Oriku, fshati Kaninë, fshati Zvërnec, sipas hartës bashkëlidhur	3% e vlerës së investimit (jo më pak se vlera minimale fiskale e ndërtimit)

3.1	Njësi banimi një familjare kur investitori është vetë familjari, zonat e tjera përveç sa specifikuar në pikën 3	2% e vlerës së investimit (jo më pak se vlera minimale fiskale e ndërtimit)
4	Ndërtesa në proces legalizimi	0.5 % e vlerës së Investimit
5	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.	0.1 % e vlerës së investimit
6	Për projektet e infrastrukturës për ndërtim në zonën industriale	1 % e vlerës së investimit
7	Për ndërtimet me deklaratë paraprake punimesh	3% vlerë preventivi
8	Strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “ <i>brand name</i> ”.	0%
9	Për projektet ku investitor ose përfitues i drejtpërdrejtë është Bashkia Vlorë	0%
10	Investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile.	0%
11	Për investimet të cilat kanë marrë statusin Investitor Strategjik, vlera e taksës do të jetë:	4 %

Në pikën 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 çmimi i shitjes do të llogaritet 70 % e çmimit të referencës.

Në pikën 1.4 çmimi i shitjes do të llogaritet 65 % e çmimit të referencës.

Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte është **0.1 për qind** e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

Struktura përgjegjëse dhe mënyra e pagesës së taksës:

Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Urbanistikës.

Taksa paguhet dhe ngarkohet në sistemin elektronik të lejeve brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit dhe lëshimit të autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Urbanistikës. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi nuk ka paguar dhe ngarkuar aktet që provojnë pagimin e taksës, autoriteti përgjegjës i dërgon kërkuesit, nëpërmjet sistemit elektronik, vendimin për refuzimin e lejes së ndërtimit.

Taksa paguhet nga individi/ subjekti i interesuar në çdo moment dhe gjithsesj jo më vonë se 45 ditë nga data e dhënies së lejes së legalizimit nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës. Nëse subjekti /personi i interesuar nuk kryen pagesën brenda këtij afati, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet kamata 0.1 për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 30 ditë pune.

Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit , në perfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar , bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Urbanistikës dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar ta shlyejë. Mos shlyerja e këtij detyrimi përben shkak për pezullimin e proceduareve të pajisjes me leje përdorimi të subjektit.

4/1 TAKSA PËR KALIMIN E TË DREJTËS SË PASURISË

Nr	Emërtimi	Njësia Administrative Vlorë Niveli i Taksës (Lekë/m ²)	Njësitë Administrative të tjera Niveli i Taksës (Lekë/m ²)
1	Ndërtesat e banimit	300	100
2	Ndërtesat për tregti dhe shërbime	700	300
3	Ndërtesa të tjera	500	200

Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

3. TAKSA E TABELËS DHE REKLAMËS

Nr.	Lloji i tabelës	Nj/matëse	Taksa
I.	Takse tabele për qëllime identifikimi, tëtrupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)		
a	Deri në 2 m²	Lekë/m ² /vit	0
b	Mbi 2 m² deri në 10 m²		
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	10,000
	Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	15,000
	Elektronike	Lekë/m ² /vit	20,000
c	Mbi 10m² deri në 20m²		
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	8,500
	Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	12,750
	Elektronike	Lekë/m ² /vit	17,000
ç	Mbi 20m² deri ne 40m²		
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	5,500
	Me ndriçim tëthjeshtë	Lekë/m ² /vit	8,250
	Elektronike	Lekë/m ² /vit	11,000
d	Mbi 40m²		
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	4,000
	Me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	6,000
	Elektronike	Lekë/m ² /vit	8,000
II	Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit nëformën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	Tabelë identifikuese		120
III	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35m²		
	E thjeshtë	Lekë/m ² /vit	22,500
	Elektronike	Lekë/m ² /vit	45,000

IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, stenda, reklamuese, banderola, etj.		
	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë/m ² /ditë	1,000

Afati i pagesës:

- Për subjektet private të regjistruara do të jetë periudha deri në 20 prill. Mospagimi në afat i detyrimit tatimor, subjekti detyrohet të paguajë gjobë me 0.06% të shumës së papaguar për çdo ditë vonesë. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.
- Për subjektet e rinj do të jetë në momentin e regjistrimit të subjektit.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: **Drejtoria e të Ardhurave Vendore.**

II. TË MIRATOJË TARIFAT VENDORE NË LLOJIN DHE NIVELIN SI MË POSHTË:

TARIFAT VENDORE

1. TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

a. Tarifa për zënie e hapësirave publike për qëllime biznesi

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Për zënie e hapësirave publike në Bulevardin Vlorë-Skelë (duke përfshirë të dyja anët e trotuarit), pedonalja te sheshi Pavarësia Skelë (në të dyja anët): - Për përdorimin e hapësirës publike sipas akt kontrolleve të terrenit - Për përdorimin e hapësirës publike për 12 muaj	500 lekë/m ² /muaj 400 lekë/m ² /muaj
2	Për zënie e hapësirave publike për zonën përgjatë Lungomares - Për përdorimin e hapësirës publike për 12 muaj - Për përdorim të hapësirës publike sipas akt kontrolleve të terrenit	400 lekë/m ² /muaj 600 lekë/m ² /muaj
3	Për zënie e hapësirave publike në zonën e Qendrës Historike (pjesa e përfunduar e projektit) - Për përdorimin e hapësirës publike sipas akt kontrolleve të terrenit - Për përdorimin e hapësirës publike për 12 muaj	400 lekë/m ² /muaj 300 lekë/m ² /muaj
4	Për zënie e hapësirave publike në zonën e Plazhit të Vjetër dhe rruga Transballkanike të dy anët e saj (vija e parë e ndërtimit).	300 lekë/m ² /muaj
5	Për zënie e hapësirave publike për zonat e tjera përveç pikës 1, 2, 3, 4	200 lekë/m ² /muaj
5	Subjekte “ambulante”*** në Njësinë Vlorë	100 lekë/m ² /muaj
6	Subjekte “ambulante”*** në Njësitë Administrative (Orikum, Novoselë, Qendër, Shushicë)	50 lekë/m ² /muaj

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e kësaj tarife dhe mënyra e pagesës:

Ngarkohet për arkëtimin e kësaj tarife, Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore për vlerësimin tatimor, do të mbështetet në informacionin e përcjellë nga struktura përgjegjëse, për shqyrtimin e kërkesave të subjekteve për dhënie e lejes për përdorim të hapësirës publike dhe përcaktimin e sipërfaqes objekt taksimi.

Subjektet që evidentohen duke përdorur hapësirë publike dhe nuk kanë lidhur akt marrëveshje, vlerësimi i hapësirës publike do të bëhet në bazë të akt kontrolleve të mbajtura nga inspektorët e terrenit të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.

- Afati i përdorimit të hapësirës publike për qëllime biznesi, do të jetë i përcaktuar sipas kontratës së lidhur apo akt kontrolleve të inspektorëve të terrenit.
- Pagesa e kësaj tarife do të kryhet përpara lidhjes së kontratës/akt marrëveshjes. Në rastin e vlerësimit tatimor sipas akt kontrollit pagesa do të kryhet sipas afatit të përcaktuar në këtë pikë.

- Përfundimisht, për subjektet që kanë një vlerë për të arkëtuar, mbi 250,000 mijë lekë për tarifën e hapësirës publike, pagesa do të jetë në dy këste: 50% në momentin e lidhjes së kontratës dhe 50% deri në afatin e pagesës së përcaktuar për këtë tarifë.

- Afati i pagesës së detyrimit tatimor do të jetë data 20 gusht.

Në rast mospagimi në afat të detyrimit tatimor, subjekti detyrohet të paguajë gjobë me 0.06% të shumës së papaguar për çdo ditë vonesë. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

- Pavarësisht se kush subjekti ushtron aktivitet në hapësirën publike, do të hiqet e drejta për përdorimin e kësaj hapësire publike, në rast se vlera korresponduese e tarifës për këtë hapësirë publike nuk është likuaduar.

a/2. Tarifa për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi Plazh

Nr.	Emërtimi	Vlera për vitin 2024
1	Për zënien e hapësirave publike në plazhin e Nartës dhe Plazhin e Vjetër	500 lekë/m ² /sezon
2	Për zënien e hapësirave publike në plazhin e Lungomares (... deri te rrapit)	800 lekë/m ² /sezon
3	Për zënien e hapësirave publike në plazhin nga Rrapi – plazhi në radhimë të Motta	1000 lekë/m ² /sezon
4	Për zënien e hapësirave publike në plazhin Radhimë të Mota – Pashaliman Orikum	800 lekë/m ² /sezon

Kërkesa për marrjen në përdorin të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi dhe të strukturës së shërbimit, sipas rastit bëhet direkt nga subjekti i interesuar nëpërmjet portalit E- Albania, sipas njoftimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Struktura përgjegjëse për përlllogaritjen e detyrimit për stacion plazhi është DPPMA. Në asnjë rast për subjektet debitorë ndaj Bashkisë Vlorë, nuk do të vijohet me procedurat e pajisjes me hapësirë publike për stacion plazhi pa përmbushur detyrimet tatimore në bashkinë Vlorë.

Afati i pagesës: Pagesa do të kryhet përpara lidhjes së kontratës apo aktmarrëveshjes, por jo më vonë se data 20 prill. Në rast mospagimi në afat të detyrimit tatimor, subjekti detyrohet të paguajë gjobë me 0.06% të shumës së papaguar për çdo ditë vonesë. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Në të gjitha rastet, për kontratat ekzistuese dhe ato të reja, të cilat janë me afat me shumë se 1-vit, subjekti duhet të paraqitet pranë drejtorisë përkatëse në Bashkinë Vlorë, për të kryer konfirmimin e marrëveshjes. Konfirmimi quhet i pranuar kur subjekti depoziton pagesën përkatëse për zërin e hapësirës publike për stacion plazhi dhe të ketë përmbushur cdo detyrim ndaj bashkisë Vlorë për subjektin që është lidhur marrëveshje (kontratë). Mospërmbushja e detyrimeve përbën kusht për moslejimin të ushtrimit të aktivitetit.

Struktura përgjegjëse: Ngarkohet për mbledhjen e kësaj tarife Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

a/3 Tarifa për Tregjet e Bashkisë Vlorë.

Tarifa për sipërfaqen e ambjentëve në tregje i nështrohen të gjitha subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në këto tregje, të cilat janë nën administrim të bashkisë Vlorë.

Baza e taksës së përkohshme të tregut është sipërfaqja në m2, e cila vihet në shfrytëzim për tregëtimin e artikujve të ndryshëm brenda territorit të tregut.

Për tregtarët që ushtrojnë aktivitet në tregjet e miratuara

➤ Në qytetin e Vlorës tarifa është 1,200 lekë/muaj.

Në rastin e pagesës së kësaj tarife më shumë se një muaj, do të aplikohen këto ulje:

2% për pagesënparadhënie3 (tre) mujore

5% për pagesënparadhënie6 (gjashtë) mujore

10% për pagesën paradhënie vjetore.

Në rast të ndërprerjes së aktivitetit nga ana e tregtarit, kjo shumë është e pakthyeshme.

Për ditët e festave zyrtare dhe të fundvitit për subjektet që ushtrojnë aktivitet në vendet e përcaktuara si tregje publike dhe çmimet i mbajnë të pandryshuara , Bashkia Vlorë këto ditë i shpall si ditë pa tarifa (Tax Free). Taksa free aplikohet për subjektet që cmimet që i mbajnë të pandryshuara nga cmimet sezonale.

Për tregun e gjësë së gjallë, të miratuara në Njësitë Administrative arkëtimi do të jetë ditor sipas aktivitetit që kryen.

- Për bagëti të trashë 100 lekë/krerë
- Për bagëti të imta 50 lekë/krerë
- Për njëthundrakët (kuaj,mushka,gomer) 100 lekë/krerë
- Për derra 50lekë/krerë
- Për shpendë fushe e uji 10lekë/krerë
- Për lepuj 10lekë/krerë
- Për çdo makinë tëparkuar 100 lekë
- Përçdo qerre 100 lekë
- Përçdo karro 50 lekë

Ngarkohet për mbledhjen e kësaj tarife inspektorët e tregut, punonjës të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.

2. TARIFA E SHËRBIMIT TË NDRICIMIT, PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

Tarifat e shërbimeve paraqiten të ndara për cdo zë dhe vlerat do të aplikohen sipas tabelës së mëposhtme:

- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve:
- Tarifa e ndricimit
- Tarifa e gjelbërimit

Nr.	Bizneset sipas grupeve			
		Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve	Tarifa e ndricimit	Tarifa e gjelbërimit
A	A. Për subjektet me xhiro 0 deri në 8 milion lek			
<i>A.I.</i>	1. Tatim pagues të grupit “shitje me pakicë”			
<i>A.I.a</i>	a) Njësitë tregtare të veshjeve, modës, luksit (butiqe), parfumeri e të ngjashme me to;	10,000	1,800	900

A.1.b	b) Njësi tregtare si bizhuteri, argjendari të floririt e metale të çmuara, e të ngjashme me to	9,300	1,800	900
A.1.c	c) Njësi të ushqimit social, restorant, piceri, fast food, kafe internete, bare, disko, pub, etj të ngjashme, përgjatë bulevardit Vlorë-Skelë, Skelë-Lungomare, Jonufër-Rradhimë-Orikum-Llogara, Vija bregdetare Plazh i vjetër-Zvërnec, Qendra Historike			
	- Sipërfaqe ndërtimi deri 100 M2	20,000	3,600	1,800
	- Sipërfaqe ndërtimi mbi 100 M2	25,000	4,500	2,250
A.1.d	d) Njësi të ushqimit social, restorant, piceri, fast food, kafe internete, bare, disko, pub, etj të ngjashme, që përfshihen në zona të tjera (50% të niveleve të pikës c)			
	- Sipërfaqe ndërtimi deri 100 M2	10,000	1,800	900
	- Sipërfaqe ndërtimi mbi 100 M2	12,500	2,250	1,125
A.1.e	e) Njësi shitje librari, kancelari, bilardo, lojra dhe video lojra fëmijesh dhe arrikuj të përdorur të ngjashëm me to	5,500	1,080	540
A.1.f	f) Për Njësi ushqimore, artikuj të përzier të karakterit ushqimor e të ngjashme me to;	10,000	1,800	900
A.1.g	g) Për Njësi tregtare mish, peshk, bulmet	10,000	1,800	900
A.2	2. Tatim pagues të grupit “shitje me shumicë“	18,000	3,240	1,620
A.3	3. Tatim pagues të grupit “prodhime, përpunime dhe tregtim			
A.3.a	a) Përpunim durali, metali, druri, tapiceri e të ngjashme me to	12,000	2,160	1,080
A.3.b	b) Prodhim tulla, tjegulla, blloqe, furra gëlqere, e të ngjashme me to	12,000	2,160	1,080
A.3.c	c) Të karakterit ushqimor: pasticeri, prodhim buke, mishi, peshku, bulmeti.	12,000	2,160	1,080
A.4	4. Tatim pagues të grupit “shërbime			
A.4.a	a) Riparim artikuj elektroshtepiake, radio, tv, pajisje fonie etj;	6,000	1,080	540
A.4.b	b) Këpuçar, parukeri, berber	6,000	1,080	540
A.4.c	c) Marangoz, elektrikist, murator, elektraout e të ngjashme	6,000	1,080	540
A.4.d	d) Për profesione të lira si avokat, noter, ekspert kontabël, mjek, mesues, topograf të ngjashëm me to;	10,000	1,800	900
A.4.e	e) Për autoshkolla, kurse të profesioneve të ndryshme;	10,000	1,800	900
A.4.f	f) Agjenci doganore, agjenci turistike, agjenci të këmbimit valutor e të ngjashme (persona fizik;	10,000	1,800	900
A.4.g	g) Për pika të shërbimit të makinave (autoservis), lavaxteri, lavazho, pastrim kimik, shërbim të rojeve civile e të ngjashme me to.	10,000	1,800	900
A.4.h	h) Për sallat e lojrave sportive: aerobi, kalçeto, palestra, e të ngjashme me to.	7,300	1,440	720
A.4.i	i) Për institucione jopublike si shkolla, kopshte, cerdhe e të ngjashme me to			
	- Deri në 10-të klasa	10,000	1,800	900
	- Mbi 10-të klasa	15,000	2,700	1,350
A.4.j	j) Për laboratore dentare, klinikë dhe laborator diagnostikues e kimik, farmaci e të ngjashme	20,000	3,600	1,800
A.4.k	k) Për motele, hotele, komplekse turistike (lekë/dhomë)	1000	180	90
C.1.e	e) Fondacione, OJF, e të ngjashme me to	3,650	900	450

B	B. Automjete			
<i>B.1</i>	1. Transport pasagjerësh			
<i>B.1.a</i>	a) Automjete deri në 9 vende	4,000	720	360
<i>B.1.b</i>	b) Automjete 10-42 vende	8,000	1,440	720
<i>B.1.c</i>	c) Automjete mbi 42 vende	12,000	2,160	1,080
<i>B.2</i>	2. Transport mallrash			
<i>B.2.a</i>	a) Automjete deri në 5 ton	4,000	720	360
<i>B.2.b</i>	b) Automjete 5-16 ton	8,000	1,440	720
<i>B.2.c</i>	c) Automjete mbi 16 ton	12,000	2,160	1,080
<i>B.2.d</i>	d) Koka tërheqëse pavarësisht kapacitetit	4,000	720	360
<i>B.3</i>	3. Transport detar për pasagjerë (mjete motorrike) Mjete lundruese detare sipas gjatësisë (m)			
<i>B.3.a</i>	a) Nga 0-5 ml	4,000	720	360
<i>B.3.b</i>	b) Nga 5,01-10ml	8,000	1,440	720
<i>B.3.c</i>	c) Mbi 10,01 ml	15,000	2,700	1,350
<i>B.4</i>	4. Mjete motorrike për peshkim Mjet lundrues për peshkim			
<i>B.4.a</i>	- nga 0-5 ml	4,000	720	360
<i>B.4.b</i>	- nga 5,01 - 10 ml	8,000	1,440	720
<i>B.4.c</i>	- mbi 10,01	15,000	2,700	1,350
<i>B.5</i>	Për subjektet që ushtrojnë aktivitet në përpunim dhe prodhim betoni, autobetoniere të cilat janë pjesë e procesit të prodhimit, nga kantieri deri në vendndodhjen e klientit, me kusht të jetë paisur me autorizim nga struktura e bashkisë			
		2,920	720	360
C	C. Për subjektet me xhiro mbi 8.01 milion lek			
<i>C.1.a</i>	a) Për subjektet me aktivitet tregëtar dhe shërbime			
	- Me qarkullim deri 20 milion lek	25,000	4,500	2,250
	- Me qarkullim mbi 20 milion lek	40,000	7,200	3,600
	- Me qarkullim mbi 50 milion lek	70,000	12,600	6,300
	- Me qarkullim mbi 100 milion lek	100,000	18,000	9,000
<i>C.1.b</i>	b) Për subjektet me aktivitet prodhimi			
	- Me qarkullim deri 20 milion lek	20,000	3,600	1,800
	- Me qarkullim mbi 20 milion lek	40,000	7,200	3,600
	- Me qarkullim mbi 50 milion lek	60,000	10,800	5,400
	- Me qarkullim mbi 100 milion lek	80,000	14,400	7,200
<i>C.1.c</i>	c) Për subjektet e lojrave të fatit, kazino, në hotele me 5 yje	400,000	72,000	36,000
<i>C.1.d</i>	d) Për subjektet me aktivitet profesione të lira	15,000	2,700	1,350
D	D. Të tjera subjekte			
<i>D.1.a</i>	a) Subjekte ndërtimi që kanë selinë me adresë jashtë kantierit të ndërtimit nga adresa ku ushtron aktivitetin kryesor	30,000	5,400	2,700
<i>D.1.b</i>	b) Subjekte me aktivitet ndërtim që kanë kantier ndërtimi për cdo vendndodhje (per secilin kantier)	123,000	18,000	9,000
<i>D.1.c</i>	c) Subjektet që kryejnë shërbime të kontraktuara me klient dhe u është miratuar leja për riparime, meremetime, lysterje dhe të ngjashme me to (përfshijë aktivitetin e ndërtimit)	26,000	2,700	1,350

E	<i>Subjektet qe kane selin kryesore jashte territorit te Bashkise Vlore dhe qe ushtrojne aktivitet me adrese dytesore ne kete territor.</i>	123,000	18,000	9,000
F	Subjekte me aktivitet ndërtim të cilët kanë deklarim zero dhe kjo vërtetohet me vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve	15.000	5.400	2.700
G	Institucionet shtetërore (entet publike, shoqëri tregëtare) të pajisur me NIPT, bazuar në numrin e punonjësve.			
	a)Për institucionet deri në 5 punonjës	50.000	500	1.500
	b) Për institucionet 5 – 20 punonjës	70.000	500	1.500
	c)Për institucionet mbi 20 punonjës	100.000	500	1.500

Përrjashtohen nga tarifa e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve, institucionet në varësi të bashkisë, institucionet që shpenzimet operative i mbulon bashkia Vlorë.

Struktura përgjegjëse për tarifën për kategorinë biznese dhe afati i pagesës:

Ngarkohen për mbledhjen e kësaj tarife Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Urbanistikës dhe Njësia e Prokurimit.

Afati i pagesës për këto tarifa është data 20 prill. Mospagimi në afat i detyrimit tatimor, subjekti detyrohet të paguajë gjobë me 0.06% të shumës së papaguar për çdo ditë vonesë. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Për efekt të procedurave tatimore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Njësia e Prokurimit në Bashkinë Vlorë ngarkohen të njoftojnë Drejtorinë e të Ardhurave Vendore për subjektet apo individët që pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi apo subjekte me leje ndërtimi për investime publike në Bashkinë Vlorë.

Detyrimet tatimore dhe gjobat kundrejt Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit do të paguhën para lidhjes së kontratës apo miratimit të lejes së ndërtimit/shfrytëzimit.

Për shoqëritë me aktivitet ndërtim përveç sa më lartë, për vendndodhjen që ka kantier ndërtimi momenti i shuarjes së përgjegjësisë tatimore për llogaritjen e detyrimeve tatimore vendore do të quhet edhe momenti i marrjes së lejes së shfrytëzimit, apo dorëzimit të punimeve tek të tretë. Në çdo rast, firma e ndërtimit është e detyruar të paraqesë aktin e marrjes së lejes së shfrytëzimit apo të dorëzimit të punimeve tek të tretë.

Në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI- mbledhja me forcë e detyrimit të papaguar, neni 102 – ndërprerja e procedurës së mbledhjes së detyrimit me forcë, të miratohet kërkesa si më poshtë:

- Taksapaguesi ka detyrimin të aplikojë pranë institucioneve (ASHK dhe DRSHTRR) të parashikuara në nenin 91 – masa e sigurimit të detyrimit tatimor (barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekore), për heqjen e masave shtënguese të sigurimit të detyrimit tatimor.

- Kërkesa e bashkisë Vlorë, drejtuar këtyre instucioneve, do ti bëhet me dijoni taksapaguesit, për vijimin e mëtejshëm të procedurës së aplikimit kundrejt tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për heqjen e masave shtrënguese të sigurimit të detyrimit tatimor.

d. Për familjet

Nr.	Emërtimi	Njësia Administrative Vlorë	Qytet Orikum	Njësitë e tjera Administrative dhe fshatrat
1	Për familje	3,300 lekë/vit	2,400 lekë/vit	1,200 lekë/vit

Përjashtohen nga kjo tarifë:

- Pensionistët
- Veteranët
- Invalidët e punës dhe të luftës
- Përfituesit e ndihmës ekonomike
- Të verbërit
- Të sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë
- Të përndjekurit politikë

Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë zyrave të agjentit tatimor dëshminë e gjendjes së tyre dhe më konkretisht:

- Të jenë kryefamiljare dhe pa persona të tjerë madhorë, përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare.
- Librezen e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, të sëmurëve paraplegjikë e tetraplegjikë, vërtetimin e të përndjekurit.

Ndarja e këtyre tarifave për efekt të evidentimit sipas zërave për qytetin Vlorë, do të bëhet përkatësisht:

- Tarifa e pastrimit 2,400 lekë/vit
- Tarifa për ndriçimin 600 lekë/vit
- Tarifa për gjelbërimin 300 lekë/vit

Ndarja e këtyre tarifave për efekt të evidentimit sipas zërave për qytetin Orikum, do të bëhet përkatësisht:

- Tarifa e pastrimit 1,800 lekë/vit
- Tarifa për ndriçimin 500 lekë/vit
- Tarifa për gjelbërimin 100 lekë/vit

Ndarja e këtyre tarifave për efekt të evidentimit sipas zërave fshatrat kjo tarifë do të klasifikohet të pastrimi për efekt të evidentimit dhe do të jetë fikse.

Struktura përgjegjëse dhe mënyra e pagesës:

Detyrimi për familjet likuqdohet në bazë mujore, referuar marrvëshjes me agjentin tatimor. Për shërbimin, agjenti përfiton deri në 3% të shumës së arkëtuar, në bazë të Akt-marrvëshjes së lidhur midis Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe agjentit tatimor.

Për tarifën e pastrim, ndricim, gjelbërim kategoria familje, mbas krijimit të regjistrave për këtë tarifë, llogaritja e detyrimit do të kryhet nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Vlorë, e cila do ti përcillet me shkresë përcjellëse agjentit tatimor.

Deri në momentin e krijimit të një regjistri nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore me të dhënat për tarifën e pastrim ndricim, gjelbërim kategoria familje, faturimi dhe arkëtimi i kësaj tarife, do vijojë të bëhet nga agjenti tatimor.

4. TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

Nr	Emërtimi	Niveli i taksës
	Automjete të licencuara për transport pasagjerësh	
1	Automjete deri në 5 vende	1,750 lekë në vit
2	Automjete 6-9 vende	3,500 lekë në vit
3	Automjete 10-25 vende	4,000 lekë në vit
4	Automjete 26-42 vende	4,500 lekë në vit
5	Automjete mbi 42 vende	4,800 lekë në vit
	Automjete të licencuara për transport mallrash	
6	Automjete deri në 2 ton	2,800 lekë në vit
7	Automjete 2-5 ton	4,000 lekë në vit
8	Automjete 5-10 ton	4,800 lekë në vit
9	Automjete 10-16 ton	5,000 lekë në vit
10	Automjete mbi 16 ton	7,500 lekë në vit
12	Parkimi orar me pagesë	50 lekë/ora
13	Parkimi vjetor me pagesë për subjekte të miratuara	30,000 lekë në vit

Struktura përgjegjëse për këtë taksë dhe mënyra e pagesës:

Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve me përgjegjësi kur parashikohet ndryshe në aktet e miratuara nga Bashkia Vlorë. Këto tarifa arkëtohen në momentin e miratimit të licencës ose rinovimit të saj.

5. TARIFA E SHËRBIMIT TË UJITJES

Në bazë të ligjit 24/2017 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit” neni 17, 18, 19 “Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe tarifa e shërbimit të ujitjes miratohen nga Këshilli Bashkiak.”

1. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së Infrastrukturës 200 lekë/ha
2. Tarifa e Shërbimit të Ujitjes 2500 lekë/ha për çdo ujitje

Struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe arkëtimin e kësaj tarife:

Për mbledhjen e tarifës së ujitjes ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit.

6. TARIFA PËR LEJE, AUTORIZIMEVE DHE VËRTETIME TË LËSHUARA NGA ADMINISTRATA E BASHKISË DHE NJËSITË ADMINISTRATIVE.

Nr	Emërtimi	Niveli i tarifës
1	Autorizim për punime në rrugë	2,000 lekë
2	Autorizim për vendosje banderolash të përkohshme	1,000 lekë
3	Autorizim për shërbim transporti jashtë linje	500 lekë

4	Autorizim për lëvizje të automjeteve (transport nxënësish, furnizim malli në subjekte, shërbime transporti në subjekte e të ngjashme.)	1,000 lekë
5	Tarifa e depozitimit të mbetjeve urbane e të ngurta jo të rrezikshme nga të tretët në vendgrumbullimin e mbetjeve	100 lekë/m3
6	Autorizim për strehim	1,000 lekë
7	Autorizime të tjera	1,000 lekë
8	Autorizim për privatizimet e kryera	1,000 lekë
9	Autorizim për privatizimet e reja	5,000 lekë
10	Autorizim për ushtrim veprimtarie si Lavazh	10,000 lekë
11	Vërtetime të tjera	100 lekë
12	Për vërtetim pasurie e pronësie	500 lekë
13	Për vendime K.B të shkurtuara etj	100 lekë
14	Tarifë shërbimi për D.D.D në të tretë (lekë/m ²)	500 lekë
15	Për dhënien e mjetit elektrik të bashkisë (lekë/orë)	5,000 lekë
16	Për palestrat e shkollave të bashkisë jashtë orarit të mësimit (lekë në muaj)	3,000 lekë
17	Nxjerrje dhe fotokopjim të dokumente arkivore me kërkesën e të interesuarit.	1,000 lekë
18	Tarifë për shërbim karroatreci	5,000 lekë

Për pikat 1- 4, 6, 8-10, 15: Për dhënien e këtyre autorizimeve, ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve.

Për pikën 5: Për dhënien e autorizimit për vend depozitimin e mbetjeve inerte ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës.

Për pikën 14: Ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Për pikën 16: Ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

Për pikat 7 dhe 17: Ngarkohen drejtoritë e bashkisë, sipas çdo rasti për autorizime të dhëna.

Për pikat e tjera ngarkohet çdo drejtori për mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij.

7. TARIFA SHËRBIMI PËR SUBJEKTET QË USHTROJNË AKTIVITET NË SEKTORIN E NDËRTIMIT

Nr	Emërtimi	Njësia	Niveli i tarifave
1	Tarifa e aplikimit për Deklaratë Paraprake Punimesh	lekë	5,000 lekë
2	Tarifa e aplikimit për Leje Zhvillimore	lekë	10,000 lekë
3	Tarifa e aplikimit për Leje Çertifikatë Përdorimi	lekë	10,000 lekë
4	Tarifa e aplikimit për Leje Ndërtimi (zhvillues njëfamiljar, objekte turistike, industriale dhe bujqësore)	lekë	5,000 lekë
5	Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e Ndërtimit	lekë	15,000 lekë
6	Tarifë shërbimi për Ngritjen e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues	lekë	10,000 lekë
7	Tarifë shërbimi për Piketimin e strukturës	lekë	15,000 lekë
8	Tarifë shërbimi për Përfundimin e themeleve dhe kuota 0.00	lekë	20,000 lekë
9	Tarifë shërbimi për Përfundimin e themeleve dhe kuota 0.00	lekë	20,000 lekë

10	Tarifë shërbimi për Përfundimin e karabinasë për të gjithë objektin	lekë	20,000 lekë
11	Tarifë shërbimi për Përfundimin e fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik;	lekë	20,000 lekë
12	Tarifë shërbimi për Përfundimin e sistemit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese.	lekë	20,000 lekë
13	Tarifë shërbimi për vërtetim konfirmim dokumenti të dalë nga arkivi teknik i Urbanistikës për dokument ligjor për dokument teknik	lekë/copë	200
		lekë/copë	700
14	Tarifë për leje përdorimi	lekë/m ²	70

Shenim: Për të njëjtin aplikim, në rast përsëritje, tarifa e aplikimit do të paguhet përsëri. Në rastet e ndryshimit të destinacionit nga ambient banimi/shërbimi në ambient për ushtrim aktivitet hotelier, tarifa e shërbimit është 0 lekë.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e tarifave:

Drejtoria e Urbanistikës, kryen mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij.

8. TARIFA PËR PËRDORIMIN E AMBIENTEVE PUBLIKE DHE MJETEVE TË INVENTARIT NË INSTITUCIONET E VARËSISË

a. Pallati i Kulturës “Labëria”

Nr	Emërtimi	Niveli i tarifës
1	përdorimin e ambientit të kinemasë (300 vende)	20,000 lekë/ditë
2	tarifë për trasmetim filmi në ekran (për cdo projektion)	10,000 lekë/film
3	përdorimin e ambienteve të sallave kati i dytë	5,000 lekë/ditë
4	përdorimin e ambienteve të sallës së muzeut	5,000 lekë/ditë
5	përdorimin e ambientit të sallës së bibliotekës	5,000 lekë/ditë
6	për përdorimin e fonisë 5000 Ë	
	brenda institucionit	6,000 lekë/ditë
	jashtë institucionit	15,000 lekë/ditë
7	për përdorimin e fonisë 1000 Ë	
	brenda institucionit	3,000 lekë/ditë
	jashtë institucionit	10,000 lekë/ditë
7	për përdorimin e sistemit të ndriçimit	20,000 lekë/ditë
8	Tarifa e biletës së kinemasë	200 lekë/biletë
9	Tarifa për vizitorët në Muze	200 lekë/biletë
10	Tarifa për vizitorët në Galeri	100 lekë/biletë

Qendra e Zhvillimit dhe Kulturës kryen mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij.

b. Teatri “Petro Marko”

Nr	Emërtimi	Niveli i tarifës
1	-për përdorimin e ambientit të sallës për koncerte	30,000 lekë/ditë
2	-përdorimin e ambienteve të sallave për aktivitete të tjera	20,000 lekë/ditë
3	-përdorimin e ambienteve të hollit për aktivitete	5,000 lekë/ditë
4	-për përdorimin e fonisë brenda institucionit jashtë institucionit	3,000 lekë/ditë 10,000 lekë/ditë
5	Biletat për në Teatrin Petro Marko (teatër dhe estradë)	500 lekë/ditë

Teatri “Petro Marko” kryen mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij.

c. Institucionet Sportive

Nr	Emërtimi	Niveli i tarifës
1	-për koncerte në Pallatin e Sportit “Flamurtari”	50,000 lekë/ditë
2	përdorimin e ambienteve të Pallatit të Sportit “Flamurtari”për aktivitete të tjera	25,000 lekë/ditë
3	për zhvillimin e aktiviteteve sportive nga subjekte jashtë strukturës së klubit “Flamurtari” NëPallatin e Sportit Në palestër	10,000 lekë/ ndeshje 5,000 lekë/ ndeshje
4	për koncerte në Stadiumin “Flamurtari”	100,000 lekë/ditë

Institucionet Sportive kryejnë mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij.

d. Rajonet Administrative të qytetit

Nr	Emërtimi	Niveli i tarifës
1	Për vërtetime të zakonshme	100 lekë
2	Vërtetime për bashkim familjar për jashtë shtetit	500 lekë

Këto tarifa mblidhen nga administratorët e bashkisë Vlorë.

e. Për Njësitë Administrative

Për përdorimin e ambienteve të Njësite Administrative Orikum, Novoselë, Qendër, Shushicë të aplikohet tarifa 5,000 lekë/ditë

f. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

Nr	Emërtimi	Niveli i tarifës
1	tarifë shërbimi për azhurnimin e rrjetit KUZ e KUB	2,000 lekë/kat
2	tarifë shërbimi për autobot e UZ	4,000 lekë/ora
3	tarifë shërbimi për skrepin	3,000 lekë/ora
4	tarifë shërbimi për kompresorin	6,000 lekë/ora
5	tarifë shërbimi për autosondën	5,000 lekë/ora
	tarifë shërbimi për rulin asfaltues	3,000 lekë/ora
	tarifë shërbimi për prerësen e asfaltit	500 lekë/ml

6	tarifë shërbimi për mjetet e transportit	400 lekë/m ³
	tarifë shërbimi për vërtetim privatizim banese	1,000 lekë
	tarifë shërbimi për vërtetim të zakonshëm	100 lekë

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike kryen mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij.

g. Administrata e konvikteve

Përdorimi i ambienteve të konvikteve të shkollave të mesme me përmbajtjen si më poshtë:

1	Për çdo krevat në konviktet e shkollave të mesme që shfrytëzohen jashtë periudhës së procesit mësimor, për grupe të organizuara.	500 lekë/krevat
---	--	-----------------

Administrata e konvikteve Publike kryen mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij.

gj . Për kopshtet dhe çerdhet në qytet

1	Tarifë për ushqimin në kopshte dhe çerdhe Për regjistrime për herë të parë (paradhënie me të drejtë kthimi kur largohet përfundimisht nga kopshti apo çerdhja)	160 lekë/ditë 3,500 lekë
---	---	-----------------------------

Për përdorimin e ambienteve të pikës a,b,c, d nga grupe studentore ose të rinjsh, tarifa është 0.

Çdo institucion arkëton tarifën nga shërbimet përkatëse që kryen.

III. Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr. 79, datë 02.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore” i ndryshuar, shfuqizohet.

IV. Për subjektet që regjistrohen për herë të parë niveli i taksave dhe tarifave vendore do të llogaritet proporcionalisht me pjesën e mbetur të vitit. Nëse rregjistrohen gjatë muajit llogaritja fillon nga data 1 e muajit dhe nese mbyllet aktiviteti gjatë muajit përgjegjësia tatimore llogaritet për të gjithë muajin.

V. Për subjektet taksapagues të cilët regjistrohen rishtazi në Qendrën Kombëtare të Biznesit:

1. Mbas datës 20 prill , afati i pagesës së detyrimit do të jetë brenda datës 20 korrik dhe
2. Mbas datës 20 korrik, afati i pagesës do të jetë 31 dhjetor.

VI. Përgjegjësia tatimore e tatimpaguesit për llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore ndërpritet kur:

- a) Në datën e aplikimit pranë Q.K.B-së për pezullim të aktivitetit, çregjistrim, kalim në regjistrin pasiv, likuidim ose faliment të biznesit të vetë.
- b) Në datën e aplikimit pranë Q.K.B-së për mbylljen e çdo adresë dytësore pranë Q.K.B dhe nuk ushtron më aktivitet në këtë vendndodhje.

VII. Autorizohet Kryetari i Bashkisë që për efekt të mbledhjes së taksës se pasurisë, të ngrëjë komisionin e verifikimit të pasurisë të paluajtshme për subjektet që nuk kanë dokumente të vërtetimit të pronësisë. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Ky komision do të kryejë verifikime dhe do t'i raportojë Këshillit të Bashkisë çdo 6 muaj për:

- a) Sipërfaqet brenda objektit (kur mungon dokumentacioni i vërtetimit tëpronësisë)
- b) Sipërfaqet e hapësirave publike në shërbim të objektit (planimetria përkatëse)

VIII. Autorizohet Kryetari i Bashkisë që të rregullojë mënyrën e arkëtimit të taksave dhe tarifave nëpërmjet Bankave të Nivelit të Dytë, Postës Shqiptare, apo pranë arkës ose llogarisë së Bashkisë në momentin e ofrimit të shërbimit sipas mundësisë sëinfrastrukturës.

IX. Kur një rrethanë financiare pengon tatimpaguesin për të paguar në afat detyrimet tatimore, ai mund të lejohet të lidhë në çdo kohë marrëveshje pagese me këste. Në të njëjtën kohë tatimpaguesi duhet të vërtetojë që është në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar të plotë detyrimin tatimor, si dhe të tregojë që pavarësisht nga rrethana financiare, ai është në gjendje të përmbushë marrëveshjen. Tatimpaguesi paraqet një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagesë me këste. Kërkesa duhet t'i drejtohet Kryetarit të Bashkisë dhe duhet të parashtrojë arsyet, që e pengojnë tatimpaguesin për të paguar detyrimet tatimore. Për të nënshkruar një marrëveshje të pagesës me këste, tatimpaguesi detyrohet të paguajë menjëherë të paktën 20% të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja. Marrëveshja e pagesës me këste nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës.

X. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë të nxjerrë urdhrat përkatës për zbatimin e këtij vendimi dhe Administrata e Bashkisë sipas përcaktimeve në këtë vendim.

XI. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6 dhe efektet financiare fillojnë në datën 01 Janar 2024.